



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2020:001042  
Datë: 11.04.2024  
Numri i dokumentit: 05560894

**E.nr.809/23**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Faton Ajvazi dhe sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në çështjen juridike përmbarimore të kreditorëve: H.S., I.N., I.B., K.N., L.B., M.H., M.M., M.R., N.H. dhe L.H., të cilët i përfaqëson av Arian Hetemi nga Lipjani, kundër debitorit Komuna e Ferizajt - Drejtoria e Arsimit, për pagesën e shpërblimit jubilar, më datë 11.04.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**PËRFUNDON** procedura përmbarimore në lëndën **E.nr.809/23**, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorëve.

**A r s y e t i m i**

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.809/23, të datës 22.05.2023, e ka caktuar përmbarimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorëve, kundër debitorit Komuna e Ferizajt - Drejtoria e Arsimit, për pagesën e shpërblimit jubilar, në bazë të aktgjykimit C.nr.42/20, të datës 20.07.2020.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përmbarimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës 30.06.2023, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe të Transfereve, që nga llogaria e debitorit ta transferoj shumën e përgjithshme të mjeteve prej 18,522.49 euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorëve.

Meqenëse kreditorët e kanë realizuar kërkesën e tyre, Gjykata konstaton se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së, dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përmbarimore në këtë çështje juridike përmbarimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
**E.nr.809/23, më datë 11.04.2024**

**GJYQTARI**  
**Faton Ajvazi**